



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12, 17 dhe 18.1 shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të datës 4 qershor 2008, nenit 9, 17, 20 të Statutit të Komunës së Lipjanit INr.110-623 të dt.26.09.2008, nenit 4, 7 dhe 8 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28. 02.2019, pas shqyrtimit të propozim vendimit të Kryetarit të Komunës miratoi këtë:

**VENDIM
PËR SHPALLJEN E INTERESIT PUBLIK PËR SHPRONËSIM TË
PALUAJTSHMERIVE**

Neni 1

Miratohet Vendimi për shpalljen e interesit publik për shpronësim të paluajtshmerive të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga projekti për ndërtimin e rrugës me trotuar, ndriçimi publik në lagjen e Konjuhut rreth shtratit të lumit "Janjevka" në Lipjan, sipas listes së pronave të përshkruara nga evidenca kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik, si dhe sipërfaqet e tyre të cilat tabela paraqesin pjesët përbërëse të këtij Vendimi.

Neni 2

Vlera e kompensimit të pronës caktohet nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë së Financave të Republikës së Kosovës konform Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010 dhe Udhëzimit Administrativë nr.02/2015 për miratimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit për përlllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin.

Neni 3

Obligohet Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ro-juridik pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të zhvilloj procedurat e shpronësimit në pajtim me dispozitat të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr.03/L-205 të datës 28 tetor 2010.

Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi obligohen: Zyra e Kryetarit-sektori pronëso-ro-juridik, Drejtorati për Urbanizëm Planifikim, Mbrojtje të Mjedisit, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, Drejtorati për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtorati i Shërbimeve Publike.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

15Nr. 464-14830
Lipjan, më 04. 03. 2019

KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

